



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:083277

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06008948

KPPP.nr.485/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Scardian” J.S.C., me NUI: 810838138, me seli në Rrugën “Perandori Justinian”, në Prishtinë, kundër debitorit Sara Loli SH.P.K., me NUI: 812007294, me seli në Rrugën “Zahir Pajaziti”, në Podujevë, të cilën e përfaqëson Kushtrim Kastrati, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.126/24 të datës 16.02.2024, të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Sara Loli SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.126/24 i datës 16.02.2024, i Përmbartuesit Privat Valdrin Beka.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.126/24 i datës 16.02.2024 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka.
- III. URDHËROHET debitori Sara Loli SH.P.K., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës”, nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 1,488.00 €, (një mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.
- IV. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbaryesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Scardian” J.S.C., ka lëshuar urdhrin përmbaryimor P.nr.126/24 të datës 16.02.2024, me të cilin ka lejuar përmbaryimin, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr.662406 të datës 10.02.2023, me të cilën është detyruar debitori që në afat prej 7 ditëve, pas pranimit të urdhrin, në emër të borxhit të mbetur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,488.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga data 11.01.2024 e deri e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbaryimore, me realizimin e përmbaryimit përmes bllokimit të gjitha llogarive bankare të debitorit në të gjitha bankat komerciale të Kosovës, regjistrimit dhe sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në realizimin e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, e ka kundërshtuar urdhrin përmbaryimor duke theksuar se nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë se cili është dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit është lejuar përmbaryimi dhe se i njëjti është lëshuar në kundërshtim me dispozitat e nenit 43 të LPP-së, pasi që propozimi i referohet policës së sigurimit, kurse të provat i referohet edhe një fature me numër 642406 të datës 10.02.2023. Ka shtuar që në rastin konkret urdhri nuk është dorëzuar në mënyrë të rregullt tek debitori, por i është dorëzuar me email në kundërshtim me nenin 48 dhe 110 të LPK-së, lidhur me nenin 18 të LPP-së. Më tutje ka theksuar që debitori ka tentuar që të shkëputë kontratën me kreditorin, por i njëjti edhe pse ishte njoftuar nga ana e debitorit, nuk ishte përgjigjur fare në këtë kërkesë e as që ka tentuar që të zgjidhin mosmarrëveshjet dhe pa paralajmërim paraprak ka ndërmarrë veprime përmbaryimore. I ka propozuar Gjykatës që të pranohet kundërshtimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri i përmbaryimit dhe të refuzohet propozimi për përmbaryim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, duke theksuar që në rastin konkret procedurën përmbaryimore e ka iniciuar në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr. 642406, duke shtuar që debitori asnjëherë nuk ka bërë kërkesë me shkrim për ndërprerjen e policës, e po ashtu ka deklaruar që nuk qëndron pretendimi i debitorit se i njëjti nuk është paralajmëruar për borxhin, meqenëse kreditori me datën 12.12.2023, përmes postës ia ka dërguar debitorit vërejtjen e fundit për borxhin e tij. I ka propozuar gjykatës që të njihet propozimi për përmbaryim dhe i njëjti të ekzekutohet sipas dispozitave ligjore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara si dhe është e përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr.662406 të datës 10.02.2023, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjtat është dorëzuar në origjinal, mban nënshkrimin e debitorit si dhe nuk është kontestuar nga debitori asnjëherë.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin që në rast të parashtrimt të ankesë kundër këtij aktvendimi, të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.485/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.